



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA HIMARË  
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE  
MBËSHTETËSE

Nr. 2926 prot.

Himarë, më 31.05.2024

**NJOFTIM PËR DËGJESË PUBLIKE**

**BANORËVE TË KOMUNITETIT TË HIMARËS DHE GJITHË PALËVE TË INTERESUARA**

Në mbështetje dhe në zbatim të ligjit Nr. 146/2014 "Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik" në nenin 9 pika 1, 3, të ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" neni 18, si dhe në Rregulloren e Këshillit bashkiak "Për konsultimet publike",

Ju njoftojmë se:

Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe Bashkia Himarë, në kuadër të projektit "**Projekt për Zhvillimin e Integruar Urban dhe Turizmit**" me financim nga Banka Botërore dhe Qeveria Shqiptare, organizojnë Diskutimin me Publikun/ Grupet e Interesit për Projektin: "**Menaxhimi, Interpretimi dhe Plani i Eksperiencës së vizitorëve, Dizajni dhe Mbikëqyrja për sítet Turistike të Kalasë së Kaninës, Kalasë së Borshit dhe Shpellës së Spilesë. Ndërhyrje Strukturore për rritjen e stabilitetit të shpatit në Kalanë e Borshit**".

Ftojme të gjithë grupet e interesit si qytetarë, biznese, grupe të marginalizuara, të rinj/të reja, shoqëri civile, të bëhen pjesë e këtyre dëgjesave për një proces transparent dhe gjithëpërfshirës.

Takimi do të zhvillohet ditën e **Martë** më datë **11.06.2024 ora 11:00, në Sallën e mbledhjeve, Bashkia Himarë.**

Takimi do të përqëndrohet në prezantimin e propozimeve kryesore dhe në diskutimet potenciale me publikun dhe grupet e interesit mbi komentet dhe pikëpamjet e tyre mbi këtë Projekt.

Mirëpresim rekomandime, propozime dhe sugjerime konkrete të cilat mund të dërgohen në adresat e mëposhtme të e-mailit:

- Koordinator për të drejtën e informimit: [erindhabili@himara.gov.al](mailto:erindhabili@himara.gov.al)
- Adresa zyrtare e bashkisë Himarë: [info@himara.gov.al](mailto:info@himara.gov.al)

Këto dëgjesa publike do të zhvillohen në bashkëpunim me bashkinë Himarë dhe anetëtarë/përfaqësues të Këshillit Bashkiak.

Jeni të lutur të merrni pjesë, pasi pjesëmarrja juaj është e rëndësishme.

**KRYETAR I BASHKISË**

**Blerina Bala**

